



Prishtinë, 20 gusht 2018
Kodi i ZRRE: V_1018_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenit 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 1, Nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 11, Neni 16 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 11, Neni 17, Neni 19, Neni 21 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT);


në seancën e mbajtur më 20 gusht 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** - Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) e cila do të jetë 8.3% reale, përkatësisht 10.2% nominale (përfshirë inflacionin e supozuar prej 1.9%, i cili gjatë azhurnimeve vjetore do të llogaritet ashtu siç është e përcaktuar në Rregullat për vendosjen e të hyrave) për periudhën e dytë rregullative 2018 - 2022, me supozimin se leverazhi (gearing-u) është 40%.
- II. Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) e përcaktuar në pikën I të këtij dispozitivi, është e njëjtë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).



ARSYETIM

-  Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) Rregullatori, në përputhje me përgjegjësitë e dhëna me legjislacionin e cekur në hyrje të këtij Vendimi, e lidhur me vendosjen e Mesatares së Ponderuar së Kostos së Kapitalit, ka zhvilluar një proces transparent, ku është përfshirë edhe konsultimi me palët e interesit:
- Më datë 15 maj 2017 ka iniciuar shqyrtimin e dytë të periudhës rregullative (prill 2018- 2022);
 - ZRRE me datë 04 korrik 2017 ka nxjerr Raport konsultativ për Mesataren e Ponderuar e Kostos së Kapitalit MPKK;
 - ZRRE me datë 05 prill 2018 ka publikuar Përgjigje ndaj komenteve, të paraqitura nga palët e interesit, në lidhje me raportin konsultativ për Mesataren e Ponderuar e Kostos së Kapitalit MPKK;
 - ZRRE, pas analizimit të raportit konsultativ për Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit MPKK, si dhe analizimit të komenteve shtesë të paraqitura nga palët e interesit, dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar ato, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi;
 - ZRRE i ka lejuar MPKK e arsyeshëm të licencuarve ashtu që të mbulojnë kostot e tyre të financimit të investimeve dhe të sigurojë kthim të arsyeshëm në kapitalin vetanak;
 - Niveli i lejuar i MPKK do të sigurojë investime cilësore duke përmirësuar nivelin e shërbimit për konsumatorët e energjisë elektrike;
 - Niveli MPKK i periudhës së dytë rregullative prej 8.3%, në krahasim me atë të periudhës së parë rregullative prej 12%, ka ardhur si rezultat i ndryshimit të shumë faktorëve përcaktues të MPKK gjatë viteve të fundit, siç janë: stabiliteti financiar dhe ekonomik, përmirësimi i ambientit të të bërit biznes në Kosovë, rënia e ndjeshme e normave të interesit të kredive investive, përmirësimi i qasjes në financa etj.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- V. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohen për zbatimin e këtij vendimi për periudhën e dytë rregullative 2018-2022.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimin të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Kompanisë Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)
- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe
- Arkivit të ZRRE-së